



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES
INSTITUTI I GJEOGRAFISE DHE INFRASTRUKTURES USHTARAKE

"VESHJE ME SISTEM KAPOT PER OBJEKTET E QAPU
SPECIFIKIME TEKNIKE NDERTIMI

Punoi: Ark. Benarda Priska



Bazuar ne “Kërkesë për veshje me system kapot për objektet e QAPU, Bunavi, nr.508; datë 25.04.2025

Qendra e Arsimimit Profesional te Ushtarëve eshte konsideruar si porta hyrese per te gjithë kandidatet per ushtare dhe oficerë ne Forcat e Armatosura te Republikes se Shiperise.

Si e tille prej vitit 2003 e deri tani ne kete institucion te rendesishem jane trajnuar nje numer i konsiderueshem personeli si rekrut, ushtar, kadet, kursant te KPO, oficerë, nënofficerë, shifer ge arrin në treth 26000 persona.

Akomodimi i kursanteve qe zhvillojne kurset respektive ne QAPU behet ne godina ne te cilat nuk ka sistem funksional te ngrohjes.


Godinat kryesore ku akomodohen kursantet janë ndërtime te vitit 1985 dhe ne vitin 2007.

Vete pozicioni ku ndodhet reparti gate dimrit ka prani te theksuar lageshtie dhe kjo gje reflektohet edhe ne pamjen e jashtme te godinave te cilave u ka rene lyerja dhe disa edhe suvaja por me kryesorja qe i ftohti reflektohet ne ambientet e brendshme ku akomodohen kursantet por edhe personeli.

Nisur nga sa me sipër, kërkohet te kryhet nje investim per veshje me sistem kapot te godinave kryesore cka do te permiresonte ndjeshem kushtet e jetesës se efektivave por edhe anën estetike te godinave dhe mbrojtjen e jashtme te tyre nga agjentet atmosferike.

Godinat qe do te vishen me sistemin kapot

1. Godina e Fjetines
2. Godina e SIA
3. Godina e SIB
4. Klasa Kabinete
5. Ish Komanda
6. Truproja
7. Komanda ekzistuese
8. Mensa



1. Godina e Fjetines

Mbi suvane ekzistuese te godines do te behet veshja me sistemin kapot, shtresat sipas detajit arkitektonik. (fasada 2500m²)

Duke qene se trashesia e sistemit kapot e kalon permasen e davancaleve ekzistuese (ne rastin qe nuk kemi nderrim dritaresh) duhet te behet vendosja e davancaleve te llamarines. (sipas detajit arkitektonik). 260ml davancale llamarine

Do te behet zevendesimi i tubave te shkarkimit vertikal me tuba shkarkimi me llamarine xingato Ø100.

